

Nr. Prot. 019/B/18

Nr. i Regjistrimit: 37

RREGULLORE PËR AUTORIZIMET E PËRGJITHSHME

KAPITULLI I Baza Ligjore, Qëllimi e Fushëveprimi dhe Definicionet

Neni 1 Baza Ligjore

- (1) Kjo rregullore është nxjerr në mbështetje të dispozitave të nenit 3, neni 9, paragrafi 3), neni 10, paragrafi 4), Kreut III, neneve 15, 16, 17 dhe 18 të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si; Ligji*); Nenit 10, paragrafi 2.1) të Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare; Direktivës 2002/20/EC të nxjerr nga Parlamenti Evropian dhe nga Këshilli i Evropës, të datës: 7 Mars 2002 mbi autorizimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike (*tutje referuar si - Direktiva e Autorizimit*); Direktivën 2002/21/EC të nxjerr nga Parlamenti Evropian dhe nga Këshilli i Evropës, të datës: 7 Mars 2002 mbi Kornizën e përbashkët për rregullimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (*tutje referuar si - Direktiva Kornizë*); Direktivën 2009/140/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës të datës 25 Nëntor 2009, e cila i ndryshon Direktivat e Autorizimit dhe atë Kornizë; Rregullores Nr.2015/2120 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 25 Nëntor 2015 për përcaktimin e masave lidhur me qasjen në internetin e hapur.

Neni 2 Qëllimi dhe fushëveprimi

- (1) Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe procedurat për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës nga ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm.
- (2) Kjo Rregullore zbatohet ndaj të gjithë ndërmarrësve, të cilët dëshirojnë të ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe kushteve të përgjithshme të miratuara nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti*) për përfshirje në aktivitete të komunikimeve elektronike.

- (3) Nëse për t'u përfshirë në aktivitetin e komunikimeve elektronike kërkohet gjithashtu edhe dhënia e së drejtës për përdorimin e resurseve të kufizuara (frekuencore dhe numerike), atëherë përpara fillimit të aktivitetit, përveç pajisjes me dokumentin e konfirmimit të njoftimit, ndërmarrësi duhet të pajiset edhe me Autorizim Individual në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe rregulloret e miratuara nga Autoriteti.

Neni 3 **Definicionet**

- (1) Për qëllim të kësaj Rregulloreje;

1.1 Kuptimi apo definicioni i secilës fjalë, frazë apo shprehje, sipas Ligjit gjithashtu do të jetë i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë Rregullore.

1.2 Shprehjet, frazat, dhe shkurtesat e mëposhtme do të kenë kuptimin si në vijim:

- a) **Autorizim i përgjithshëm** – akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga korniza ligjore, e përcaktuar nga Ligji dhe rregullat e nxjerra nga Autoriteti, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve specifike të komunikimeve elektronike;
- b) **Facilitete shoqëruese** – shërbime të lidhura, infrastruktura fizike dhe objektet tjera ose elementet që lidhen me një rrjet dhe/ose me një shërbim të komunikimeve elektronike të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose që kanë potencialin për ta bërë këtë dhe përfshijnë, ndër të tjera, edhe ndërtesat apo hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe konstruksionet tjera mbështetëse, kanalet, përçuesit, shtyllat, pusetat, dhe kabinetet;
- c) **Integriteti i Rrjetit** – i referohet aftësisë së sistemeve të ndërlidhura për të ruajtur dhe mbajtur në masë optimale gjendjen e tyre të punës dhe të të mbeturit të pandikuar nga interkoneksionet me rrjetet e tjera. Sigurimi i integritetit të rrjetit (QoS – kualiteti i shërbimit, obligimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë). P.sh. integriteti i të dhënave (të dhënat janë pikërisht ato që janë dërguar: asgjë e shtuar, asgjë e ndryshuar, asgjë e fshirë);
- d) **Interferencë e dëmshme** – ndërhyrja, e cila rrezikon funksionimin e shërbimit të radionavigimit, ose shërbimeve të tjera të sigurisë, ose të cilat në forma të ndryshme seriozisht përkeqësojnë, pengojnë ose ndërprejnë, në mënyrë të përsëritur, shërbimet e radio-komunikimeve, funksionojnë në bazë të ligjit dhe akteve tjera nënligjore;
- e) **Interkoneksioni** – lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga i njëjti apo nga ndërmarrës të ndryshëm, në mënyrë që t'i lejojë përdoruesit e një ndërmarrësi të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtit ose të një ndërmarrësi tjetër, ose të lejojë qasjen për shërbimet e ofruara nga një ndërmarrës

tjetër. Interkoneksioni është një lloj i veçantë i qasjes, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit;

- f) **Linja me qira** – linjë e pakomutuar e komunikimeve elektronike që lidhë pikat terminuese të një rrjeti të komunikimeve elektronike;
- g) **Ndërmarrës** – çdo person fizik dhe/ose juridik, ose një grup personash të bashkuar në bazë të kontrollit apo të varësisë, të cilët janë të përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës ose veprimet e të cilave, nëse realizohen, kanë qëllim ose mund të kenë ndikim në aktivitetin ekonomik në Republikën e Kosovës;
- h) **Shërbim me vlerë të shtuar** – është, për aq sa ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë, çdo shërbim që kërkon përpunimin e të dhënave për trafikun ose të dhënave për vendndodhjen e të tjera nga të dhënat për trafikun përtej asaj që është e nevojshme për transmetimin e një komunikimi ose faturimit të tij;
- i) **Shërbimi universal** – një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë shfrytëzuesit në territorin e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme;
- j) **Thirrjet në Shërbime të Emergjencës** – thirrjet në institucione që ofrojnë shërbime të emergjencës.

KAPITULLI II

Bazat e së drejtës për përfshirje në aktivitetet e komunikimeve elektronike

Neni 4 Procedura e Njoftimit

- (1) Ndërmarrësi, i cili dëshiron të ofroj rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, përpara fillimit të ushtrimit të aktivitetit duhet të përfundoj procedurën e njoftimit përmes plotësimit të formularit “**Njoftim për hyrje në aktivitetin e komunikimeve elektronike**” sipas formatit të specifikuar në Shtojcën I të kësaj rregulloreje ose përmes aplikimit online në Platformën elektronike të publikuar në web faqen e ARKEP.
- (2) Aktivitetet e komunikimeve elektronike, të cilat ndërmarrësit duhet të njoftojnë Autoritetin janë paraqitur në vijim:
 - 2.1 Ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të telefonisë fikse;
 - 2.2 Ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të telefonisë mobile;
 - 2.3 Ofrimi i shërbimeve të linjave me qira;
 - 2.4 Ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve satelitore të komunikimeve elektronike;
 - 2.5 Ofrimi i shërbimeve të transmetimit të të dhënave;

2.6 Ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar

- (3) Në rast se ndërmarrësi nuk e ka të qartë se ku duhet të përfshihet aktiviteti i komunikimeve elektronike, sipas ndarjes së prezantuar në paragrafin 2) të këtij neni, atëherë duhet të kërkohet sqarim nga Autoriteti, i cili do e jep sqarimin brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e marrjes së kërkesës.
- (4) Autoriteti nuk do t'i ngarkoj ndërmarrësit me asnjë kosto financiare për procedurën e njoftimit.
- (5) Ndërmarrësi, i cili njofton për ofrimin e shërbimeve dhe/ose rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligj dhe rregulloret e miratuara nga Autoriteti, ka të drejtë:
- 2.1 të negocioj për interkoneksion dhe kur është e zbatueshme të marr qasje nga ndërmarrësit tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
 - 2.2 për tu përcaktuar si ofrues i shërbimit universal për shërbimet e veçanta në skemën e shërbimit universal.
- (6) Ndërmarrësit janë të detyruar që të njoftojnë Autoritetin për të gjitha ndryshimet në informacionin e paraqitur gjatë njoftimit, brenda tridhjetë (30) ditëve nga ndodhja e tyre dhe atë:
- 3.1 Kur kërkohet të njoftohen aktivitete tjera, përveç atyre të deklaruara në njoftimin fillestar;
 - 3.2 Kur kërkohet të ndërpritet një ose disa nga aktivitetet e komunikimeve elektronike;
 - 3.3 Kur është e nevojshme të bëhet ndonjë ndryshim lidhur me njoftimin e aktivitetit.
- (7) Kur informacioni për njoftim nuk është i kompletuar ose nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Autoriteti brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e marrjes së njoftimit informon ndërmarrësin për nevojën e plotësimit të dokumentacionit të munguar. Plotësimi i dokumentacionit duhet të bëhet brenda një afati jo më të gjatë se tridhjetë (30) ditë nga data e njoftimit.
- (8) Ndërmarrësi, i cili ka kompletuar dhe dorëzuar njoftimin, si dhe është pajisur me certifikatë konfirmimit nga Autoriteti sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, ka të drejtë të ushtroj vetëm aktivitetin/et e përcaktuara në Certifikatën e Njoftimit të Konfirmimit.
- (9) Ndërmarrësit, të cilët për të ofruar shërbime dhe ose rrjete publike të komunikimeve elektronike duhet të përdorin resurse të kufizuara sipas nenit 2, paragrafit 3) të kësaj rregulloreje, duhet që të plotësojnë në të njëjtën kohë edhe për resurse të kufizuara numerike dhe/ose frekuencore.

Neni 5 Konfirmimi i Njoftimit nga Autoriteti

- (1) Brenda pesë (5) ditëve të punës, nga data e kompletimit të njoftimit nga ndërmarrja, Autoriteti e regjistron ndërmarrësin në listën e regjistrimit në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje si dhe konfirmon me shkrim për kryerjen e regjistrimit, sipas formatit të specifikuar në Shtojcën II të kësaj rregulloreje.
- (2) Certifikata për konfirmimin e njoftimit vërteton se;
 - 2.1 ndërmarrësi ka plotësuar Formularin e njoftimit në formatin e duhur;
 - 2.2 ndërmarrësi do të ofroj rrjete dhe/ose shërbimet, të cilat i ka njoftuar dhe janë të specifikuara në regjistrin e njoftimit;
 - 2.3 ndërmarrësi do të zbatoj kushtet e përgjithshme për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të specifikuara në Shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Regjistri i Njoftimit

- (1) Autoriteti administron një regjistër të përditësuar, të gjeneruar përmes një baze të të dhënave në të cilën ruhet informacioni i ndërmarrësve. Regjistri i ndërmarrësve, i cili publikohet në ueb faqen e Autoritetit përmban këto të dhëna:
 - 1.1 Emrin dhe adresën e ndërmarrësit;
 - 1.2 Numrin e regjistrimit të biznesit;
 - 1.3 Përshkrim të shkurtër të rrjetit dhe/ose shërbimit që do të ofrohet;
 - 1.4 Datën e lëshimit të certifikatës dhe
 - 1.5 Data e fillimit të aktivitetit.

Neni 7

Detyrimet e Ndërmarrësve

- (1) Ndërmarrësit, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike janë të detyruara që t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme të specifikuara në Shtojcën III të kësaj rregulloreje.
- (2) Në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti, ndërmarrësit janë të detyruar që të dërgojnë pranë Autoritetit të dhënat dhe raportet për veprimtarinë e tyre.
- (3) Të gjithë ndërmarrësit, të cilat operojnë nën regjimin e autorizimit të përgjithshëm, duhet të kryejnë të gjitha obligimet financiare në përputhje me Ligjin dhe Rregulloret e miratuara nga Autoriteti.
- (4) Ndërmarrësit, të cilët ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike nuk duhet të tejkalojnë deklaratimet e bëra në njoftimin e aktivitetëve në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje.

- (5) Nëse ndërmarrësi, i cili ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike nuk vepron në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë rregullore, atëherë Autoriteti do të veproj në përputhje me nenin 103 të Ligjit dhe rregullores të miratuar nga Autoriteti mbi sanksionet ekonomike.

Neni 8

Mbyllja e aktivitetit

- (1) Kur ndërmarrësi mbyll aktivitetin e njoftuar dhe të regjistruar nga Autoriteti, ajo është e detyruar të njoftojë Autoritetin brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e mbylljes sipas formularit në Shtojcën I. Autoriteti pasi verifikon plotësimin e detyrimeve ligjore të ndërmarrësit bën çregjistrimin e tij nga regjistri.
- (2) Nëse ndërmarrësi ka njoftuar Autoritetin për mbylljen e aktivitetit dhe ka në përdorim resurse të kufizuara (frekuenca dhe numeracion), atëherë Autoriteti përveç veprimeve të parashikuara në paragrafin 1) të këtij neni, revokon vendimin/et dhe autorizimet respektive me të cilin/ët i është/janë dhënë të drejtat mbi resurset e fundme.
- (3) Nëse një ndërmarrës i regjistruar do të bëjë mbylljen e aktivitetit të tij për shkak të bashkimit me një subjekt tjetër, atëherë ai është i detyruar të njoftojë Autoritetin për ngjarjen e pritshme brenda 30 ditëve para ndodhjes. Ndërmarrësi i ri ka detyrimin të zbatojë procedurën për ndryshimet në Njoftimin e Regjistrimit, sipas kësaj rregulloreje.
- (4) Nëse ndërmarrësi nuk fillon me ofrimin e shërbimit brenda periudhës kohore prej dy (2) vitesh nga data e paraparë për fillimin e aktivitetit, Autoriteti rezervon të drejtën që të inicioj procedurat e nevojshme për çregjistrimin e ndërmarrësit nga regjistri.
- (5) Nëse të gjitha aktivitetet e komunikimit elektronike do të mbyllen, pagesat vjetore do të llogariten bazuar në rregullimet ligjore, nënligjore dhe akteve rregullatore në fuqi, deri në ditën e njoftimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

KAPITULLI III

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare dhe Hyrja në fuqi

Neni 9

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

- (1) Të gjithë ndërmarrësit, të cilët aktualisht ushtrojnë aktivitetin e komunikimeve elektronike dhe u janë lëshuar konfirmime të njoftimit, do të vazhdojnë aktivitetin e tyre në përputhje me detyrimet e specifikuar në këtë rregullore.
- (2) Ndërmarrësit, të cilët posedojnë licenca individuale, janë të obliguar që brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje të dorëzojnë formularin e njoftimit tek Autoriteti. Me këtë rast këta ndërmarrës nuk janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet e kërkuara në pikën I, V dhe VI të formularit të njoftimit, me përjashtim të rasteve kur të

dhënat janë ndryshuar nga koha kur është licencuar ndërmarrja, të cilat nuk janë të parapara me raportimet periodike.

- (3) Në rast se ndërmarrësit e referuar në paragrafin 2) të këtij neni brenda afatit kohor të përcaktuar sipas paragrafit 2) të këtij neni nuk dorëzojnë formularin e njoftimit, atëherë Autoriteti do të inicioj procedurat për revokimin e Licencave, të cilat i posedojnë këta ndërmarrës.
- (4) Nëse një ndërmarrës, i cili është i licencuar në përputhje me Ligjin mbi Telekomunikacion Nr. 2002/7, paraqet njoftim pranë Autoritetit, atëherë Autoriteti do ta zëvendësoj Licencën me Autorizim.
- (5) Nëse Licenca ekzistuese përfshinë edhe të drejtën e shfrytëzimit të resurseve të kufizuara frekuencore, Autoriteti do të lëshoj një vendim që jep të njëjtat të drejta (*autorizim individual*) për të përdorur këto resurse për të njëjtën periudhë kohore të specifikuar në Licencë.
- (6) Gjitha marrëveshjet komerciale të arritura në mes ndërmarrjeve të autorizuara nga Autoriteti do të vazhdojnë të zbatohen edhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
- (7) Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Departamenti i Komunikimeve Elektronike dhe Departamenti Ligjor.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

- (1) Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Autoritetit dhe mbetet në fuqi derisa nuk miratohet ndonjë rregullore tjetër.
- (2) Kjo rregullore shfuqizon Rregulloren nr.25 për Autorizimet e Përgjithshme (*Ref. Nr.Prot.015/B/14*).
- (3) Shtojcat I, II dhe III janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Prishtinë, 16/04/2018

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit të ARKEP

Autoriteti do të procedoj me shqyrtimin e Formularit të Njoftimit vetëm pas kompletimit të Dosjes dhe do ta njoftoj ndërmarrësin për vendosjen në Regjistrin e Njoftimit brenda 5 (pesë) ditëve të punës nga data e kompletimit të Njoftimit.

I. QËLLIMI I NJOFTIMIT:

- Fillimi i shërbimit
 Shtim shërbimi
 Heqje shërbimi

II. TË DHËNAT PËR NDËRMARRËSIN:

1.1	Emri i Ndërmarrësit (Entiteti)	
1.2	Numri i Regjistrimit	
1.3	Adresa	
1.4	Numri i Telefonit	
1.5	Numri i Faksit	
1.6	E-mail adresa	

III. TË DHËNAT PËR ZYRTARIN LIGJËRISHT TË PËRGJEGJËSHËM:

2.1	Emri i zyrtarit	
2.2	Adresa	
2.3	Numri i Telefonit	
2.4	Numri i Faksit	
2.5	E-mail adresa	
2.6	Numri i ID	

IV. AKTIVITETET TË CILAT NJOFTOHEN/CREGJISTROHEN:

Nr.	Aktiviteti	Lloji
1.	Ofrimi i rrjetit publik fiks	<input type="checkbox"/> Lokal
		<input type="checkbox"/> Nacional
		<input type="checkbox"/> Tjera (<i>specifikoj</i>)
2.	Ofrimi i shërbimeve publike fikse	<input type="checkbox"/> Shërbime telefonike lokale/nacionale
		<input type="checkbox"/> Shërbime telefonike ndërkombëtare
		<input type="checkbox"/> Telefona publik me pagesë

Nr.	Aktiviteti	Lloji
		<input type="checkbox"/> Shërbime tjera (<i>specifikoj</i>)
3.	Ofrimi i rrjetit publik mobil	<input type="checkbox"/> Lokal
		<input type="checkbox"/> Nacional
4.	Ofrimi i shërbimeve publike mobile	<input type="checkbox"/> Shërbime telefonike të zërit
		<input type="checkbox"/> Transmetim të dhënash
5.	Ofrimi i shërbimeve të linjave me qira	<input type="checkbox"/> Fibër optik të pa-ndriçuar
		<input type="checkbox"/> Linja tjera me qira
6.	Ofrimi i rrjetave publike me transmetim satelitor	<input type="checkbox"/> Ofrimi i rrjetave publike me transmetim satelitor
7.	Ofrimi i shërbimeve publike satelitore	<input type="checkbox"/> Ofrimi i shërbimeve publike satelitore
8.	Ofrimi i shërbimeve të transmetimit të të dhënave (Internetit)	<input type="checkbox"/> Ofrimi i shërbimeve publike të transmetimit të të dhënave (Internetit)
9.	Ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar	<input type="checkbox"/> Ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar

V. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT DHE FAZA E OFRIMIT:

<p>Përshkrimi i rrjetit dhe/ose shërbimit që do të ofrohet</p> <p>(Të jepen përshkrime të detajuara për secilin aktivitet të njoftua duke specifikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A do të përdoret rrjeti vetanak apo ndonjë rrjet tjetër • Teknologjia e cila do të përdoret • Radio frekuencat, të cilat planifikohen të përdoren • Lista e shërbimeve që planifikohen të ofrohen, • Etj. <p>Mund të përdoret ndonjë Shtojcë i veçantë në rast se hapësira nuk është e mjaftueshme)</p>	
<p>Faza e Ofrimit</p> <p>(Të specifikohet koha e parashikuar për fillimin e aktivitetit të komunikimeve elektronike)</p>	

VI. DOKUMENTET E BASHKANGJITURA:

Dokumentet e bashkangjitura si shtojce aplikacionit te Njoftimit	<ol style="list-style-type: none">1. Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit2. Kopje e Certifikatës së numrit fiskal3. Kopje e dokumentit 'Informatë mbi biznesin
--	--

VII. KONFIRMIMI I NJOFTIMIT:

Ndërmarrja kërkon që t'i lëshohet certifikata e konfirmimit të njoftimit për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të njoftuara përmes këtij formulari:

PO

JO

VIII. DETYRIMET LIGJORE:

Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se do të ushtroj aktivitetet në fushën e komunikimeve elektronike të shënuara më sipër dhe aplikoj për regjistrim në regjistrin e ofrueseve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të Autoritetit (ARKEP).

Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam mbyllur aktivitetet e komunikimeve elektronike të shënuara më sipër.

Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam mbyllur çdo aktivitet të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të përgjithshëm.

Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se të dhënat e mia kanë pësuar ndryshime, sikurse përshkruhen në formular.

Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam ndryshuar formën ligjore të ndërmarrjes sime siç përshkruhet në formular. Emri i vjetër është si më poshtë;

Unë nëpërmjet këtij dokumenti paraqes në ARKEP të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe/ose të gjithë dokumentet që sigurojnë se nënshkruesi i këtij Njoftimi Regjistrimi ka lidhje me personin përfaqësues.

Unë deklaroj se informacioni që përfshihet në deklarin e paraqitur, sikurse çdo informacion tjetër shoqërues, është i saktë dhe i vërtetë, dhe jam plotësisht i vetëdijshëm për faktin që, lidhur me angazhimin në çdo aktivitet të komunikimeve elektronike për të cilin është e nevojshme të sigurosh të drejtën e përdorimit për numeracion dhe frekuenca, të drejta të cilat nuk sigurohen nëpërmjet kësaj procedurë, unë duhet të paraqes një aplikim për të fituar të drejtat e përdorimit të cituara më sipër përpara fillimit të ofrimit të shërbimit.

Data e Njoftimit: _____

Nënshkrimi dhe Vula: _____

Vendi: _____

KONFIRMIM**I NJOFTIMIT**

Nr. Prot _____; datë ___/___/___

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti*), konfirmon se Ndërmarrësi “_____” me adresë: _____ dhe Numër të Regjistrimit të Biznesit _____, ka paraqitur Njoftimin e Regjistrimit sipas Nenit 16 të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 dhe është regjistruar në Regjistrin e ndërmarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm;

4. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

a)

5. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:

a)

Ndërmarrësi i regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të mësipërme, e cila operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është e detyruar të zbatojë Kushtet e përgjithshme të specifikuara në Shtojcën III të Rregullores për Autorizim të Përgjithshëm (*Ref. Nr.Prot.*) dhe ka të drejtë:

1. të negocioj për interkoneksion dhe kur është e zbatueshme të marr qasje nga ndërmarrësit tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
2. për t’u përcaktuar si ofrues i shërbimit universal për shërbimet e veçanta në skemën e shërbimit universal.

Kryetari i Bordit

(nënshkrimi dhe vula e Autoritetit)

Kushtet e Përgjithshme për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm**1) Përdorimi i resurseve Frekuencore**

- 1.1 Në rast se ndërmarrësi për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike do të përdor resurse frekuencore, atëherë së bashku me njoftimin për regjistrim duhet të aplikoj edhe për pajisjen me Autorizim Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave.
- 1.2 Dhënia e së drejtës për përdorim të frekuencave, bëhet nga Autoriteti në përputhje me kërkesat e Ligjit për Komunikime Elektronike Nr.04/L-109 dhe procedurat e specifikuar në Rregulloren për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave si dhe rregullat tjera në përputhje me Ligjin për definimin e brezeve frekuencore me rëndësi të veçantë ekonomike.
- 1.3 Ndërmarrësi, i cili është pajisur me Autorizim Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave:
- a) është e detyruar që të zbatojë dispozitat e përcaktuara në Ligjin e Komunikimeve Elektronike, aktet nënligjore në zbatim të tij, Planin Kombëtar të Radio-frekuencave, Planin e Përdorimit të Radio Frekuencave, Rregulloren dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave, si dhe çdo akt tjetër normativ që ndryshon/plotëson, apo zëvendëson këto rregullore;
 - b) nuk ka të drejtë të përdor frekuenca të pa përcaktuara në Autorizimin Individual, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe me Ligj dhe Rregullore;
 - c) është e detyruar t'i përdorë frekuencat apo brezat e frekuencave të caktuara në Autorizimin Individual vetëm për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve, për të cilat i janë caktuar;
 - d) pranon që, për përdorimin e frekuencave për të cilat nuk kërkohet miratim paraprak nga Autoriteti, nuk i garantohet asnjë mbrojtje ndaj çfarëdo interference të mundshme dhe se nuk është i lejuar t'i përdor frekuencat në fjalë për të shkaktuar interferencë tek stacionet e tjera të radio-komunikimeve. Në qoftëse konstatohet se si rezultat i mos zbatimit të kushteve dhe specifikimeve të dhëna këtu apo si rezultat i mos funksionimit adekuat të pajisjeve të përdorura janë shkaktuar interferenca të dëmshme tek stacionet e radio-komunikimit të të tjerëve, është i detyruar të ndalojë menjëherë përdorimin e tyre.
 - e) Nuk mund të transferojë tek palët e treta frekuencat e caktuara për përdorim në Autorizimin Individual, pa miratimin paraprak të Autoritetit.

2) Përdorimi i resurseve Numerike

- 2.1 Në rast se ndërmarrësi për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike do të përdor resurse numerike, atëherë së bashku me njoftimin për regjistrim duhet të aplikoj edhe për pajisjen me Autorizim Individual, respektivisht Vendimin për caktimin dhe përdorimin e resurseve numerike.

- 2.2 Dhënia e së drejtës për përdorim të numeracionit/blloqeve numerike, bëhet nga Autoriteti në përputhje me procedurat e specifikuar në Rregulloren për Planin e Numeracionit. Resurset numerike mund të përdoren vetëm pas ndarjes së tyre nga Autoriteti.
- 2.3 Ndërmarrësi, i cili është pajisur me Autorizim Individual për caktimin dhe përdorimin e resurseve numerike:
- a) është e detyruar që të zbatojë dispozitat e përcaktuara në Ligjin e Komunikimeve Elektronike, aktet nënligjore në zbatim të tij, Rregullores për Planin Kombëtar të Numeracionit, si dhe çdo akt tjetër normativ që amandamenton, apo zëvendëson këto rregullore;
 - b) nuk ka të drejtë të përdor numra/blloqe numerike të pa përcaktuara në Vendim, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe me Ligj dhe Rregullore;
 - c) është e detyruar t'i përdorë numrat/blloqet numerike të caktuara në Vendim vetëm për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve për të cilat i janë caktuar;
 - d) duhet të siguroj përdorim efektiv të resurseve numerike.
 - e) Nuk mund të transferojë tek palët e treta resurset numerike e caktuara për përdorim në Autorizimin Individual, pa miratimin paraprak të Autoritetit.
 - f) Duhet të siguroj portabilitetin e numrave në përputhje me Rregullat e miratuara nga Autoriteti dhe atëherë kur kërkohet nga Autoriteti.

3) Caktimi i kodevetë rrjeteve mobile (MCC), kodeve të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC)

- 3.1 Kodet MNC, ISPC dhe NSPC do të caktohen në përputhje me Rregulloren për Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës të **miratuar** nga Autoriteti.

4) Dhënia e Informacionit për Autoritetin

- 4.1 Të gjithë ndërmarrësit e përfshirë në aktivitetet e komunikimeve elektronike janë të detyruara për të dhënë informacion pranë Autoritetit në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Komunikime Elektronike dhe Rregulloreve tjera të miratuara nga Autoriteti.
- 4.2 Autoriteti do të siguroj fshehtësinë e informatave konfidenciale në përputhje me kushtet dhe procedurat të përcaktuara në aktet ligjore.

5) Ndërtimi dhe Përdorimi i Përbashkët i Rrjetave të Komunikimeve Elektronike

- 5.1 Rrjetet publike të komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të ndërtohen dhe shfrytëzohen në përputhje me kërkesat e Ligjit për komunikime elektronike dhe me aktet tjera nënligjore në zbatim të tij, me legjislacionin në fuqi për planifikimin territorial dhe ndërtimin, për mbrojtjen e mjedisit, si dhe me standardet e tjera teknike.
- 5.2 Ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike kanë të drejtë që të instalojnë infrastrukturën e komunikimeve elektronike në tokën që është pronë e tyre sipas së drejtës së pronësisë, ose për të cilën është vendosur një servitut, ose kur ofruesit kanë të drejtë ta përdorin atë në baza të tjera pa e ndryshuar destinimin e tokës.

- 5.3 Instalimi, e drejta për shteg, mbrojtja, dhe bashkë-shfrytëzimi i infrastrukturës së komunikimeve elektronike duhet të bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe rregullat e miratuara nga Autoriteti.
- 5.4 Në qoftë se një ofruer i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nuk mund ta realizojë të drejtën për të instaluar infrastrukturën e domosdoshme të komunikimeve elektronike, ose shpenzimet për realizimin e të drejtës së tillë janë disproporcionalisht të larta, Autoriteti mund të kërkojë nga cilido ofruer i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose nga një person tjetër që kontrollon infrastrukturën përkatëse që të lejojë, në kushte jo-diskriminuuese, shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës ekzistuese të komunikimeve elektronike, si dhe të tubacioneve të tjera përkatëse, kanaleve kablore, kolektorëve, kullave, shtyllave, ndërtesave dhe objekteve tjera ose instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, aty ku ajo është me kosto të arsyeshme dhe nuk kërkon punë të rëndësishme shtesë.
- 5.5 Kur një operator nuk mund ta realizoj të drejtën për të shtrirë rrjetin e komunikimeve elektronike, as përmes;
- a) Shtrirjes së përbashkët;
 - b) ndarjes së Infrastrukturës;
 - c) me ndonjë mënyrë tjetër,
 - d) e gjithashtu në rastin e dështimit të negociatave me pronarët e pronave, të cilat mund të përdoren për shtrirjen e Infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike,

ky operator mund t'i drejtohet gjykatës për dhënien e së drejtës, kur një mundësi e tillë ekziston dhe kur kjo nuk paraqet një barrierë të panevojshme për pronarin, që ta përdor pronën shtetërore, komunale ose private për shtrirjen e infrastrukturës duke krijuar te drejtën e servitutit në këtë pronë.

- 5.6 Çdo ndërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike është e obliguar që;
- a) të marrë çdo masë të nevojshme dhe çdo leje të kërkuar për ndërtimin dhe përdorimin e faciliteteve të nevojshme për funksionimin efektiv të Rrjeteve apo Shërbimeve që ofron;
 - b) të mirëmbajt pajisjet e komunikimit elektronik që përdor, në mënyrë që të sigurojë që këto pajisje dhe facilitete të mos i shkaktojnë asnjë dëm personave apo pronës së të tjerëve, duke shmangur çdo rrezik të mundshëm.
 - c) Rrjeti të jetë i instaluar, mirëmbajtur dhe funksionon në atë mënyrë që të mos shkaktoj interferencë të dëmshme ndaj ndërmarrësve dhe përdoruesve tjerë spektrit frekuencor dhe të zbatoj me përpikëri marrëveshjet ndërshtetërore për koordinim ndër-kufitar.

6) Detyrimet për ofrimin e rrjetave dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike

- 6.1 Çdo ndërmarrës që operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike është i detyruar të marrë masa gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura, drejtpërdrejt ose nëpërmjet personave të tretë, në mënyrë që të garantojë:

- a) Sigurinë, integritetin dhe mirëmbajtjen e funksioneve të rrjeteve të komunikimit elektronik të përdorur dhe/ose të kontrolluar nga një ndërmarrës i caktuar, si dhe sigurinë, integritetin dhe mirëmbajtjen e çdo rrjeti tjetër të komunikimeve elektronike që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm brenda shkallës së kontrollit nga ndërmarrësi në fjalë.
 - b) Ndërveprimin e shërbimeve të ofruara nga ndërmarrja me shërbimet korresponduese të ofruara nga ndërmarrësit tjerë.
 - c) Mbrojtjen e të dhënave personale në masën që është brenda kontrollit të tij, si dhe zbatimin e çdo dispozite në fuqi lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, konfidencialitetit të komunikimeve, mbrojtjen e privatësisë, dhe fshehtësisë së komunikimeve elektronike.
 - d) Lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente, të përcaktuara aipas Ligjit Nr.05/L-030 për përgjimin e komunikimeve elektronike dhe zbatimin e detyrimeve, që burojnë nga ky legjislacion.
 - e) Kushtet për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës apo të gjendjes së luftës.
 - f) Mbrojtjen e shtetasve ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetik, të përhapur nga rrjetet e komunikimeve elektronike;
 - g) Të mos ndërmerr veprime anti-konkurrese dhe antiligjore, të cilat e dëmtojnë zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike ose janë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga Autoriteti, për kualifikim të fenomeneve të ndaluara në telekomunikacion apo akteve tjera normative të aplikueshme.
 - h) të mos bëjë marrëveshje ekskluzive me palët e treta për lokacionin e pajisjeve të tij, të cilat janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese.
 - i) Mbrojtjen e ambientit dhe të planit rregullues në përputhje me rregullat e miratuara nga organet kompetente shtetërore.
- 6.2 Cilido ndërmarrës që ofron shërbime publike telefonike është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të sigurojë qasje pa pengesë në shërbimet e emergjencës.
- 6.3 Obligimet shtesë për ofruesit e shërbimeve të qasjes në internet:
- 6.3.1 Ofruesit e shërbimeve të qasjes në internet gjatë ofrimit të shërbimeve duhet të trajtojnë gjitha llojet e trafikut në mënyrë të barabartë, në baza jo diskriminuese, pa kufizime ose interferenca, dhe pavarësisht nga dërguesi dhe pranuesi, përmbajtja e qasur ose shpërndar, aplikacionet ose shërbimet e ofruara apo shpërndara, ose pajisja terminale e përdorur.
 - 6.3.2 Ofruesit e shërbimeve të qasjes në internet nuk duhet të përfshihen në masat e menaxhimit të trafikut, të cilat shkojnë përtej masave të arësyeshme të menaxhimit të trafikut, duke bllokuar, ngadalësuar, ndryshuar, kufizuar, ndërhyrë, degraduar ose diskriminuar në mes të përmbajtjeve specifike, aplikacioneve ose shërbimeve, ose kategorive të veçanta, përveç nëse është e nevojshme dhe vetëm për aq kohë sa është e nevojshme.

6.3.3 Masat e arsyeshme të menaxhimit të trafikut mund të jenë gjithashtu të domosdoshme për të parandaluar mbingarkimin e rrjetit, në situatat kur mbingarkimi është gati të materializohet dhe për të zbutur efektet e mbingarkesës së rrjetit, atëherë kur një mbingarkim i tillë ndodhë vetëm përkohësisht ose në rrethana të jashtëzakonshme.

6.3.4 Ofruesit e shërbimeve të qasjes në internet mund të aplikojnë masat e manaxhimit të trafikut në rastet si në vijim:

6.3.4.1 Për të përmbushur kërkesat nga Legjislacioni i aplikueshëm ose një vendim Gjykate;

6.3.4.2 për të ruajtur integritetin dhe sigurinë e rrjetit,dhe

6.3.4.3 Parandalimin e mbingarkimit të rrjetit.

6.4 Ofruesit e shërbimeve të qasjes në internet nuk duhet të vendosin kufizime në përdorimin e pajisjeve terminale që kyçen në rrjet, përveç atyre të imponuara nga prodhuesit ose distributorët e pajisjeve terminale.

7) Shërbimi Universal

7.1 Çdo ndërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike zbaton të gjitha detyrimet që mund t'i vendosen lidhur me ofrimin e shërbimit universal në përputhje me kërkesat e ligjit për komunikimet elektronike dhe rregullat e miratuara nga Autoriteti.

8) Detyrimet dhe masat rregullatore për ndërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT)

8.1 Në qoftëse ndërmarrësi që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike është përcaktuar nga Autoriteti me fuqi të ndjeshme në ndonjë treg pas analizës së tregut, ajo është e detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet rregullatore 'ex-ante' që Autoriteti vendos në zbatim të ligjit dhe akteve të tjera të miratuara.

9) Qasja dhe Interkoneksioni i Rrjeteve

9.1 Të gjithë ndërmarrësit e autorizuar nga Autoriteti për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike kanë të drejtë të negociojnë për interkoneksion dhe Qasje me ndërmarrësit tjerë, të cilat operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, në përputhje me procedurat e përshkruara në Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe dokumentet tjera rregullatore të miratuara nga Autoriteti;

a) Rregullorja për Sigurimin e Qasjes

b) Rregullorja për interkoneksionin

c) Rregullorja për Bashkë-shfrytëzimin e Plotë dhe të përbashkët të lakut dhe nën-lakut lokal

d) RIO e publikuar e operatorëve me FNT;

e) RUO e publikuar e operatorëve me FNT.

f) çdo vendim tjetër i Autoritetit i nxjerrë për këtë qëllim.

9.2 Për realizimin e interkoneksionit dhe/ose qasjes ndërmarrësit lidhin midis tyre marrëveshje Interkoneksioni dhe/ose qasje, një kopje e të cilave depozitohet në Autoritet.

10) Kërkesat teknike

- 10.1 Të gjithë ndërmarrësit, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të zbatojnë rregullat e miratuara nga Autoriteti të specifikuar në rregulloret përkatëse dhe të gjitha rregulloret tjera, të cilat i zëvendësojnë apo amendamentojnë rregulloret në vijim;
- a) Rregullorja për kualitetin e shërbimeve të komunikimeve elektronike,
 - b) Rregullorja për kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike,
 - c) Rregullorja teknike për radio pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese dhe kompatibilitetit elektromagnetik (*njohja e konformitetit*)
- 10.2 Të gjithë ndërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të publikojnë specifikimet e ndërfaqeve/interfejsave të përdorura për ofrimin e shërbimeve.

11) Mbikëqyrja dhe Inspektimi

- 11.1 Për kontrollin e zbatueshmërisë së ligjshmërisë dhe kushteve të përcaktuara nga Autoriteti për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, Autoriteti mbikëqyrë veprimtarinë e ndërmarrësve në përputhje me ligjin për komunikime elektronike dhe rregulloren për inspektim.
- 11.2 Nëse vërehet degradimi i kualitetit të shërbimit, Autoriteti mund të vendosë kërkesat lidhur me karakteristikat teknike, kërkesat për kualitetin minimal të shërbimit dhe masat tjera të përshtatshme dhe nevojshme tek një ose më shumë ofrues të shërbimeve të qasjes në internet për publikun, përfshirë ofruesit e shërbimeve të qasjes në internet.
- 11.3 Autoriteti duhet të aplikojë masat e monitorimit dhe raportimit për t'u siguruar se ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, duke përfshirë ofruesit e qasjes në internet përbushin obligimet e tyre për të siguruar qasje të hapur në internet.
- 11.4 Çdo ndërmarrje e cila ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të lejojë inspektorët e Autoritetit që të kryejnë inspektim kudo ku ka pajisje të komunikimeve elektronike si dhe t'u ofrojnë inspektorëve të Autoritetit të gjitha informatat dhe dokumentacionin e kërkuar.
- 11.5 Me kërkesë të Autoritetit, ofruesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, përfshirë ofruesit e shërbimit të qasjes në internet duhet t'i vënë në dispozicion të Autoritetit informacionin lidhur me menaxhimin e trafikut dhe kapacitetin të rrjetit të tyre si dhe arsyetimet për masat e aplikuarat të menaxhimit të trafikut.

12) Mbrojtja e Konsumatorit

- 12.1 Çdo ndërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të zbatojë detyrimet ligjore lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve. Çdo marrëveshje që sjell kufizime apo eliminim të përgjegjësive të ndërmarrësit në këtë drejtim konsiderohet e pavlefshme.
- 12.2 Ndërmarrësit janë të detyruar të aplikojnë procedurën për shqyrtim të menjëhershëm të kërkesave dhe ankesave të bëra nga konsumatorët lidhur me instalimin, fillimin,

përfundimin, faturimin dhe kualitetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

- 12.3 Ndërmarrësit janë të detyruar të informojnë Autoritetin, kur kjo gjë kërkohet nga Autoriteti, lidhur me të gjitha kërkesat dhe ankesat e mësipërme të firmosura në mënyrën e duhur dhe që i janë paraqitur ofruesit. Informacioni i mësipërm mund të përfshijë gjithashtu edhe informacionin mbi mënyrën dhe kohën e plotësimit të këtyre kërkesave.
- 12.4 Ndërmarrësit duhet të sigurojnë ekzistencën e procedurave për shqyrtimin e problemeve që hasen nga konsumatorët dhe duhet të kenë zyrat, respektivisht personat përgjegjës për shërbim ndaj konsumatorëve.
- 12.5 Konsumatorët kanë të drejtë që të qasen dhe shpërndajnë informacionin dhe përmbajtjen, përdorin dhe ofrojnë aplikacione dhe shërbime dhe përdorin pajisje terminale sipas zgjedhjes së tyre, pa marrë parasysh lokacionin e konsumatorit ose ofruesit të shërbimit, origjinën ose destinacionin e informatës, përmbajtjen, aplikacionin ose shërbimin, nëpërmes shërbimit të tyre të qasjes në internet.

13) Kontratat

- 13.1 Ndërmarrësit duhet të sigurojnë kycjen ose qasjen në rrjetin publik të komunikimeve elektronike, në bazë të kontratës që lidhin me konsumatorët në zbatim të legjislacionit në fuqi.
- 13.2 Kushtet e përfshira në Kontratë duhen të jenë sa më qarta, të sakta dhe të thjeshta, në mënyrë të tillë që konsumatorët të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm për të gjitha kushtet kontraktuale.
- 13.3 Kërkesat shtesë lidhur me çështjen e kontratave përfshirë çështjet e net neutralitetit duhet të jenë në përputhje me Rregulloren për Kontratat, Transparencën dhe Publikimin e informatave të miratuar nga Autoriteti.

14) Detyrime për Mbrojtjen Kombëtare dhe Sigurinë e Rendit Publik

- 14.1 Ndërmarrësi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të bashkëpunojë me organet kompetente të përcaktuara në Kushtetutë dhe legjislacionin e Kosovës lidhur me mbrojtjen kombëtare dhe çështje të sigurisë publike.
- 14.2 Ndërmarrësit që ofrojnë qasje në rrjetet dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar integritetin e rrjetit të komunikimeve publike dhe qasje në shërbimet e komunikimeve publike, të zbatueshëm në situatë të jashtëzakonshme të dështimit katastrofal të rrjetës ose forcës madhore siç janë: kushtet e jashtëzakonshme klimatike, tërmetet, vërshimet, rrufetë apo zjarret, si dhe rastet tjera të jashtëzakonshme.
- 14.3 Ndërmarrësit duhet të zbatojnë masat emergjente përgjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës të jashtëzakonshme.
- 14.4 Në përputhje me rregullat e specifikuar në Ligj dhe aktet tjera të miratuara nga Autoriteti, ofruesit e rrjetave dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të japin prioritet absolut komunikimeve me shërbime emergjente dhe telekomunikimeve që bëhen nga krerët e shtetit, kabinetit të qeverisë, komandantët e forcave tokësore dhe ajrore, përfaqësuesit konsullor apo diplomatik të Kosovës, dhe shteteve tjera anëtare të unionit

ndërkombëtar te telekomunikimeve, sekretariatit te përgjithshëm te kombeve te bashkuara dhe tribunalit ndërkombëtar.

14.5 Informatat që përmbajnë në vete sekrete shtetërore dhe/ose janë zyrtare duhet të transmetohen nëpërmes radio kanaleve komunikuese të koduara.

15) Shërbimet e emergjencës

15.1 Ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik duhet t'ju mundësojnë Përdoruesve qasje në numrin e emergjencës '112', ose numrat e tjerë të emergjencës të përcaktuar në ligj, pa pagesë nga çdo pajisje fundore e konsumatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike mobile dhe fikse dhe/ose telefonat publike.

15.2 Ofruesit e Shërbimit Telefonik Publik janë të detyruar të sigurojnë pa pagesë gjithë informacionin e nevojshëm teknikisht të realizueshëm dhe në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për identifikimin e vendndodhjes së personit që ka thirrur autoritetet kompetente në mënyrë që të veprojnë me emergjencë, për të gjitha thirrjet e bëra në numrin e emergjencës '112'.

15.3 Ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik që ofrojnë Shërbime të Mesazheve të Shkurta (SMS), në mënyrë që t'u shërbejnë personave që kane probleme serioze me të folurit dhe dëgjimin, ose personave, të cilët për shkak të rrethanave të caktuara nuk mund të realizojnë thirrje, janë të detyruar të sigurojnë qasje në shërbimet e emergjencës pa pagesë nëpërmjet Shërbimit të Mesazheve të Shkurtra (SMS).

16) Numërori telefonik dhe shërbimet e informacionit

16.1 Ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik janë të detyruar, përveç dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale:

a) T'u sigurojë Përdoruesve me qasje të paktën një shërbim të kërkimit të informacionit në Numërorin Telefonik i cili mbulon të gjithë numrat e konsumatorëve të regjistruar në telefoninë zanore ose fikse dhe komunikimin personal. Në qoftëse shërbimi i kërkimit të informacionit në Numërorin Telefonik është pjesë e Shërbimit Universal, atëherë ofruesit e shërbimit të telefonisë zanore janë të detyruar t'ju sigurojnë konsumatorëve qasje në të paktën një shërbim të kërkimit të informacionit në Numërorin Telefonik si pjesë e Shërbimit Universal.

b) T'ju sigurojë Përdoruesve të të gjithë telefonave të tyre publike, në se kjo është teknikisht e mundur, qasje në shërbimet e informacionit në përputhje me Planin e Numeracionit.

16.2 Gjithë ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik që caktojnë numra telefonik janë të detyruar të informojnë konsumatorët e tyre, mbas lidhjes së kontratës përkatëse,

a) të drejtën e tyre për t'u përfshirë në numërorët telefonikë të disponueshëm për publikun; dhe

b) të drejtën e tyre të kontrollojnë dhe në se është e nevojshme të korrigjojnë ose të kërkojnë fshirjen e të dhënave të tyre nga numërori. Një konsumator ka të drejtë t'i kërkojë operatorit që i ka caktuar numrin e telefonit në se të gjitha ose një pjesë e numrave ose të dhënave personale të tij/saj mund të përfshihen në numërorin

telefonik të disponueshëm për publikun, apo në se një pjesë apo të gjitha të dhënat personale dhe numrat e tij mund të bëhen të disponueshëm për të tretët.

- 16.3 Mënyra e përdorur nga konsumatori, për të shprehur dëshirën e tij mbi atë nëse dëshiron të përfshihet në numërorin telefonik të operatorit të tij, duhet të jetë në përputhje me kushtet e parashikuara në ligj për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e komunikimeve elektronike.
- 16.4 Ofruesit e shërbimit telefonik publik që caktojnë numra telefonikë, përpara se të transferojnë detaje të konsumatorëve të tyre tek palët e treta, janë të detyruar të informojnë konsumatorët e tyre pa pagesë në se kjo është e mundur, si dhe për personin që do të marrë apo kategorinë e atyre që mund të marrin këtë informacion, si dhe qëllimin e transferimit, i cili nuk mund të jetë i ndryshëm nga ai për të cilin janë marrë këto të dhëna për herë të parë. Në këtë mënyrë konsumatorët kanë mundësinë të shprehin dëshirën e tyre lidhur me këtë transferim ashtu siç përcaktohet dhe në ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e komunikimeve elektronike.
- 16.5 Konsumatorëve me kartë telefonike të parapaguar ju kërkohet të njoftojnë dëshirën e tyre me shkrim ose në mënyrë elektronike tek operatori i tyre, në se dëshirojnë të përfshihen në numërorin telefonik apo jo.
- 16.6 Çdo ofrues i shërbimit telefonik publik që cakton numra telefonike për konsumatorët e tij është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë të arsyeshme për sigurimin, brenda kuadrit të ofrimit të numërorit telefonik dhe informacionit për numrat, e informacionit përkatës në një formë të caktuar dhe në një rrugë që është e qartë, objektive, e paanshme dhe e orientuar në kosto.
- 16.7 Ofruesit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të jenë të paanshëm kur përpunojnë dhe paraqesin detajet e Përdoruesve të tyre ose detajet që u bëhen të disponueshëm atyre nga ofrues të tjerë të shërbimit publik telefonik.
- 16.8 Ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet të negociojnë ndërveprimin pas kërkesës së bërë nga një ofrues tjetër i shërbimit publik telefonik për të pasur qasje në shërbimet reciproke të informacionit për numrat, brenda kuadrit të informacioneve që janë të hapura për publikun në shërbimet e tyre të informacionit për numrat.
- 16.9 Ndërmarrësit janë të detyruar të sigurojnë që qasja e Konsumatorëve të një rrjeti të komunikimeve elektronike në shërbimet e kërkimit të informacionit në Numërorin Telefonik, që sigurohet me kod të shkurtër, nëpërmjet një rrjeti tjetër të komunikimeve elektronike ose në shërbimet e siguruara nga i njëjti rrjet i komunikimeve elektronike, në një zonë tjetër gjeografike, mund të realizohet nëpërmjet kodit të shkurtër, pa kërkuar formimin e një prefiksi të veçantë që i është caktuar rrjetit apo zonës gjeografike.
- 16.10 Ofruesit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të zbatojnë instruksionet e dhëna nga Autoriteti lidhur me çështjen e shërbimit të kërkimit të informacionit në Numërorin Telefonik.
- 16.11 Ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet të sigurojnë që ata vetë t'i përgjigjen çdo pyetje të bërë nga konsumatorët lidhur me çmimin e ngarkuar për thirrjet drejt shërbimit të kërkimit të informacionit në Numërorin Telefonik, me kode të shkurtër, që sigurohen nëpërmjet rrjeteve të tyre.

17) Fatura

- 17.1 Çdo faturë e dërguar Konsumatorëve nga ofruesi, që tregon koston e shërbimeve telefonike të kryera, duhet të jetë sa më e thjeshtë dhe t'u dërgohet konsumatorëve nga ofruesi i shërbimit, pa pasur nevojën e një pagese shtesë.
- 17.2 Përveç kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike, Autoriteti ka të drejtë të përcaktojë nivelin e detajeve të faturës që i dërgohet pa pagesë konsumatorëve nga ofruesit e Shërbimeve të komunikimeve elektronike, kështu që konsumatorët të jenë në gjendje:
- të verifikojnë dhe kontrollojnë shumat që i janë ngarkuar për përdorimin e rrjetit publik telefonik në vendndodhje fikse; dhe
 - të monitorojnë përdorimin e tyre dhe kostot përkatëse në mënyrë të përshtatshme, pra të kenë një nivel të arsyeshëm kontrolli mbi faturat e tyre.
- 17.3 Çdo thirrje e bërë nga një konsumator pa pagesë, përfshirë thirrjet në linjat e ndihmës, nuk duhet të përfshihet në faturën e detajuar të konsumatorit.
- 17.4 Detyrimi për dhënien e një niveli minimal të detajimit nuk zbatohet në qoftëse konsumatori ka deklaruar në mënyrë të shprehur se nuk dëshiron të marrë një faturë të tillë.
- 17.5 Kërkesat shtesë lidhur me çështjen e faturave duhet të jenë në përputhje me Rregulloren për Kontratat, Transparencën dhe Publikimin e informatave të miratuar nga Autoriteti.

18) Tarifat

- 18.1 Pavarësisht nëse faturat për Shërbimet Publike Telefonike hartohen mbi bazën e sasisë së informacionit të transmetuar apo kohëzgjatjes së tij, faturat nuk duhet të mbulojnë periudha shërbimi më të gjata se një muaj.
- 18.2 Konsumatorët nuk duhen faturuar për thirrje të papërfunduara për mos përgjigje të palës së thirrur, as dhe për kohën e harxhuar derisa pala e thirrur të përgjigjet. Në qoftëse ka dyshime lidhur me faturat, konsumatori ankohet me shkrim tek ndërmarrja brenda 15 ditëve mbas marrjes së faturës.
- 18.3 Faturat duhet të specifikojnë afatin e fundit për pagimin e tyre, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga data e dërgimit të faturës. Ndërmarrësit duhet të marrin masa që faturat e nxjerra t'i dërgohen konsumatorëve sa më shpejt që është e mundur.

19) Transparenca dhe publikimi i informacionit

- 19.1 Ndërmarrësit e rrjetave dhe/ose shërbimit publik të komunikimeve elektronike janë të detyruar të publikojnë informacion të saktë, të qartë dhe të përditësuar lidhur me tarifat e tyre dhe kushtet për qasje dhe përdorim të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nga Përdoruesit Fundorë.
- 19.2 Informacioni i publikuar duhet të përfshijë sa vijon:
- Emrin e Ndërmarrësit dhe adresën e zyrave të saja qendrore.
 - Përshkrim të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun që ai ofron.

- c) Procedurën që ndjek një konsumator për paraqitjen e aplikimit për ofrimin e shërbimeve.
- d) Nëse ka tarifë të kycjes dhe/ose pagesë periodike, përshkrim të shërbimeve që përfshihen (p.sh. shërbime të informacionit, faturim i detajuar, mirëmbajtje, etj.).
- e) Tarifat standarde që mbulojnë qasjen, gjithë llojet e pagesave të përdorimit dhe mirëmbajtjes, duke përfshirë detaje rreth uljeve të zakonshme ekzistuese dhe synimet speciale të skemave të tarifimit. Duhet përfshirë një përshkrim i mjaftueshëm i çmimeve individuale që zbatohen në çdo rast ndaj shërbimeve përkatëse për lloje të rrjeteve, destinacion dhe zgjatje të çdo thirrje. Përveç kësaj, duhet të ketë një përshkrim të qartë të niveleve të tarifimit, në se ka të tillë.
- f) Politikën e kompensimit/ç'dëmtimit, duke përfshirë detaje të sistemit të kompensim/ç'dëmtimit.
- g) Llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes që ofron, duke përfshirë afatin kohor të lidhjes së shërbimeve që ofron ose riparimin e defekteve.
- h) Parametrat e kualitetit për shërbimeve e ofruara siç janë përcaktuar nga Autoriteti.
- i) Kushtet standarde kontraktuale, duke përfshirë, në se është e nevojshme, zgjatjen minimale të kontratës.
- j) Mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe rregullimin e llogarive.
- k) Hartat e mbulueshmërisë sipas teknologjisë për operatorët mobil. Këto harta duhet të përditësohen në baza të rregullta.

19.3 Informacioni i mësipërm duhet publikuar si vijon:

- a) Duke i dërguar informacionin e mësipërm, dhe në mënyrë të veçantë çdo tekst të kontratës së zbatueshme apo pjesë të saj, çdo Përdoruesi Fundor që paraqet një kërkesë.
- b) Duke vendosur informacionin e mësipërm në faqen elektronike të Ndërmarrësit, ose në qoftëse kjo faqe nuk ekziston, duke e bërë materialin e mësipërm të disponueshëm për çdo palë të interesuar pa pagesë në zyrat qendrore të Ndërmarrësit.
- c) Në mënyrë më specifike, çdo sipërmarrës është i detyruar të japë gjithë informacionin që lidhet me tarifat në çdo pikë shitjesh të shërbimeve ose të verë në funksionim një qendër telefonike që jep informacion mbi tarifat.

19.4 krahas obligimeve të mësipërme, ofruesit e shërbimeve të qasjes në internet janë të obliguar të publikojnë:

19.4.1 informacionin se si ndikojnë masat e aplikuara të menaxhimit të trafikut në kualitetin e shërbimeve të qasjes në internet, privatësinë e përdoruesve fundorë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të tyre.

19.4.2. Një sqarim të qartë se si çdo kufizim i vëllimit, shpejtësisë dhe parametrave tjerë të kualitetit të shërbimit në praktikë mund të kenë ndikim në shërbimet e qasjes në internet dhe në veçanti përdorimin e përmbajtjes, aplikacioneve dhe shërbimeve.

20) Detyrime lidhur me vendosjen e telefonave publikë

- 20.1 Dispozitat e mëposhtme i përkasin detyrimeve shtesë që u vendosen ndërmarrësve që ofrojnë telefona publikë. Kështu, çdo ndërmarrës që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe vendos telefona publikë është i detyruar të zbatojë dispozitat e mëposhtme.
- 20.2 Për qëllim të këtij paragrafi, telefonat publikë janë ata që janë instaluar në mënyrë të përhershme në vende publike ku qasje është e mundur 24 orë.
- 20.3 Çdo ndërmarrës që ofron telefona publikë duhet të sigurojë mundësinë e thirrjes së numrave të emergjencës pa pagesë.
- 20.4 Ndërmarrësit janë të detyruar të tregojnë informacionin vijues, në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe lehtësisht të dallueshme, në zonën ku janë instaluar telefonat:
- Informacion mbi pagesat e bëra dhe mënyrat e pagesës për shërbimet në fjalë. Duhet të ketë një informim të mjaftueshëm dhe të qartë për çmimet individuale që zbatohen për destinacionin dhe kohën kur është bërë thirrja. Përveç kësaj, duhet të ketë informim të qartë mbi nivelin e tarifimit dhe tarifën minimale.
 - Duhet të tregohet mundësia e kryerjes së thirrjeve të emergjencës.
 - Duhet të tregohet mundësia e marrjes të thirrjeve hyrëse.
 - Numri i kontaktit nëse ka ankesa ose probleme.
 - Ndërmarrja që ofron telefona publikë duhet të sigurojë që çështjet lidhur me personat me aftësi të kufizuara të merren në konsideratë në instalimin dhe ofrimin e telefonave publikë.

21) Detyrime lidhur me ofrimin e kartave të parapaguara dhe shërbimeve, të cilat do të ofrohen pa marrëveshje të shkruar

- 21.1 Ofruesit e shërbimeve pa marrëveshje të shkruar janë të obliguar të publikojnë në web faqen e tyre nëse kanë dhe ose ofroj përdoruesve fundorë një kopje të rregullave të tij para se përdoruesi fundor të paguaj për shërbim,, një fletë informacionesh që përmban gjithë informacionin për tarifën, siç përshkruhet në paragrafin vijues ose të vënë në funksionim një qendër telefonike, që siguron pa pagesë, informacion të detajuar mbi tarifën dhe çështjet tjera rreth net neutralitetit.
- 21.2 Informacioni që duhet siguruar për tarifën duhet të tregojë mjaftueshëm dhe qartë, informacionin e mëposhtëm:
- çmimet individuale që zbatohen në çdo rast ndaj shërbimeve përkatëse sipas tipit të rrjetit;
 - nivelin e tarifimit, pagesën minimale ose pagesën për përgjigjen ndaj thirrjes, nëse ka të tillë;
 - uljet që zbatohen zakonisht;
 - datën e përfundimit të ofrimit të shërbimit.

22) Rrezatimi Elektromagnetik

22.1 Ndërmarrësi i autorizuar do të pajtohet me çdo standard të emetimit të rrezatimit konform rekomandimeve të organizatës botërore të shëndetësisë dhe institucioneve tjera relevante si dhe standardeve tjera të miratuara dhe të publikuara në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.

23) Siguria e rrjeteve publike

23.1 Ndërmarrësi i autorizuar duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kundër të qasjes së paautorizuar mbështetur në dispozitat e Ligjit për Komunikimet elektronike, Direktivën 2002/58/EC amendamentuar me Direktivën 2009/136/EC, Direktivën 2006/24/EC të Këshillit dhe Parlamentit Evropian dhe rregullave të miratuara nga Autoriteti.

24) Pagesat

24.1 Ndërmarrësit, të cilët veprojnë nën regjimin e autorizimit të përgjithshëm janë të obliguar që të kryejnë pagesat pranë Autoritetit në përputhje me Ligjin për Komunikimet elektronike dhe rregullat e miratuara nga Autoriteti.

24.2 Pagesat që kryhen tek Autoriteti janë:

- a) Pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe Rregullores për pagesat e mbikëqyrjes së tregut të miratuar nga Autoriteti.
- b) Pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, në përputhje me nenin 57 të Ligjit dhe Rregullores për tarifat e spektrit të miratuar nga Autoriteti.
- c) Pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloret e miratuara nga Autoriteti.
- d) Pagesa nga dënimet ekonomike të shqiptuara nga Autoriteti, në përputhje me nenin 101 të Ligjit.
- e) Pagesa për financimin e shërbimit universal, në përputhje me nenin 28 të Ligjit.